

20251092383

QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 47, paragrafi (6) të Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 83/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/17, 83/18, 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 152/19, 244/19, 275/19, 110/21, 123/22, 65/23 dhe 218/24), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2025, miratoi:

**RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET MË TË AFËRTA PËR PAGESAT
DIREKTE, PËRDORUESIT E MJETEVE, SHUMAT MAKSIMALE DHE MËNYRËN E PAGESAVE
DIREKTE PËR VITIN 2025**

Neni 1

Në Rregulloren për kriteret më të afërta për pagesat direkte, përdoruesit e mjeteve, shumat maksimale dhe mënyrën e pagesave direkte për vitin 2025 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 26/25 dhe 88/25), në nenin 2, paragrafi (2), në tabelë, në nënmasën 2.6, në kolonën "Kriteret më të afërta dhe Shuma e pagesave direkte", në alinenë 3, fjalët "së paku 50%" zëvendësohen me fjalët "së paku 30%".

Neni 2

Në nenin 4, në pikën 1, fjalët "31 maj 2025" zëvendësohen me fjalët "31 korrik 2025".

Neni 3

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. 50-762/9
27 maj 2025
Shkup

Zëvendëskryeministri i Qeverisë
së Republikës së Maqedonisë së Veriut
prof.d-r Hristijan Mickoski, n.p